

## **STATUT**

### **I**

## **SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR GJIKONDLA SH.P.K**

Sot, më datë 21 Dhjetor 2018, Z.Agron Gjikondi, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. G40311112L lindur më 11.03.1964 themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur GJIKONDI SH.P.K në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë statut.

### **NENI 1**

#### **EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është GJIKONDLA sh.p.k, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”)

### **NENI 2**

#### **THEMELIMI**

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, Shqipëri.

### **NENI 3**

#### **SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake nr.9, Bulevardi “Zogu i Parë”, Pallati Nr 103, zona kadastrale 8350, dyqani nr.3, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë zyra dhe/ose të kryejë veprimtari e biznese ne vende të tjera, qoftë brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të administratorëve të Shoqërisë.

Administratori mund të vendosë për të lidhur një kontratë qiraje për zyrën e regjistruar dhe/ose të ndryshojë selinë e regjistruar të Shoqërisë dhe të paraqesë vendimin përkatës pranë autoriteteve kompetente shqiptare. Nëse ky veprim kërkon një përditësim dhe ndryshimin e këtij neni, me qëllim për të reflektuar adresën e re të selisë së regjistruar të Shoqërisë, administratori ka të drejtë dhe është i autorizuar për të marrë një vendim apo deklaratë të tillë.

#### **NENI 4 OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është të ndërrmarrë çdo veprim ose aktivitet tregtar të ligjshëm për zhvillimin e të cilave një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të themelohet dhe regjistrohet sipas legjislacionit shqiptar i ndryshuar rast pas rasti duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Argjendari, përkthime
- Tregëti, import - eksport
- Shoqëria mund të marrë pjesë me cilësinë e ortakut apo aksionerit në shoqëri të tjera tregtare me objekt veprimtarie të njëjtë apo të ndryshëm nga i saj.

#### **NENI 5 ORTAKËT DHE KAPITALI FILLESTAR**

Kapitali fillestar i Shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë, me vlerë totale 100.000 Lekë (njëqind mijë) si më poshtë:

- Agron Gjikonđi, i ditëlindjes 11.03.1964, shtetas shqiptar, me Nr. të kartës së identitetit G40311112L, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (dyzetë mijë) Lekë.

Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin shqiptar.

Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

#### **NENI 6 KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

#### **NENI 7 ORTAKËT**

Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

- Z.Agron Gjikonđi, i ditëlindjes 11.03.1964, shtetas shqiptar, me nr. të kartës së identitetit G40311112L, mbajtës i 1 (një) kuote me vlerë 100,000 (dyzetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, ortaku mund të marr vendime, por pa u kufizuar vetëm si më poshtë:

- Përcaktimin e politikave të veprimtarisë së Shoqërisë
- Ndryshimi i Statutit
- Miratimin e bashkimit me shoqëri të tjera
- Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit
- Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertëve Kontabel
- Miratimin e skemës së kompensimit për Administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabel
- Mibkqyrjen e implementimit të politikave tregtare nga administratorët duke përfshirë mbikqyrjen e përgatijes së pasqyrave financiare dhe raporteve të aktivitetit
- Miratimin e raportit të administratorëve dhe pasqyrave financiare dhe cdo pasqyre tjetër brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar
- Shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve
- Riorganizimin dhe shpërndarjen e Shqërisë
- Prishjen e shoqërisë dhe emërimin e likuidatorit/ëve
- Çështje të tjera të përcaktuara në statut

Mbledhja e asamblesë thirret nga Administratori(ët) përmes një njoftimi me shkrim për mbledhjen jo më pak se 7 dite përpara ditës së mbledhjes. Në përputhje me ligjin asambleja duhet të thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme me shumicën e votime të ortakëve të pranishëm vetëm nëse janë të pranishëm ose përfaqësohen ortakët, të cilët përfaqësojnë 50% të kapitalit të shoqërisë.

## **NENI 8**

### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Pronat, biznesi dhe punët e shoqërisë do të administrohen nga një ose më shumë administatorë. Administratori i shoqërisë është z Agron Gjikondi, i ditëlindjes 11.03.1964, shtetas shqiptar, me nr. të kartës së identitetit G40311112L.

Shkarkimi ose zëvendësimi i administratorëve do të bëhet me anë të një vendimi të ortakëve dhe shkarkimi apo zëvendësimi nuk do të konsiderohet si ndryshimin e këtij statuti dhe vendimi përkatës i ortakëve nuk është i nevojshëm të reflektohet në statut.

- Mandati i administratorit/ëve do të jetë 5 vjet.

- Administratorit/ët mund të shkarkohen në çdo kohë nga Ortakët.
- Administratorit/ëve i jepen të gjitha kompetencat e përcaktuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por u kufizuar në sa vijon:
- Administrimi dhe kryerja e operacioneve të shoqërisë në Shqipëri, si dhe kryerjen e çdo veprimi që mund të jetë i nevojshëm për drejtimin e veprimtarisë së Shoqërisë;
- Organizimi i operacioneve të Shoqërisë dhe kryerjen e këtyre operacioneve;
- Përfaqësimi i shoqërisë kundrejtë të gjitha subjekteve publike dhe/ose private, qoftë subjekte dhe/ose autoritete shqiptare apo të huaja;
- Nënshkrimi, hartimin e çdo dokumenti, duke përfshirë edhe ato financiare, hapja dhe/ose mbyllja e llogarive bankarë në emër të Shoqërisë, në monedhë të huaj dhe shqiptare, si dhe nënshkrimin, hartimin e çdo dokumenti në lidhje me këto llogari bankare, kryerjen e të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari bankare, kryerjen e të gjitha veprimeve të ligjshme në këto llogari;
- Punësimin dhe shkarkimin e punëmarrësve në kuadër të politikavë të përcaktuara nga Shoqëria;
- Realizimi i çdo veprimi tjetër të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm administrativ për administrimin e Shoqërisë;
- Nënshkrimi dhe dorëzimi i deklaratave tatimore dhe të deklaratave të tjera dhe raporteve pranë Regjistrisë Tregtare shqiptare dhe Zyrës së Tatimeve, si dhe pranë të gjitha organeve të tjera shtetërore të autorizuara dhe institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore ku kërkohet një dorëzim i tillë;
- Lidhjen, nënshkrimin dhe kryerjen e çdo transaksioni (duke përfshirë shitjen dhe blerjen e pasurive të paluajtëshme), pa asnjë kufizim vlere;
- Kryerjen e të gjitha akteve të tjera, veprimeve dhe çështjeve për administrimin efikas të Shoqërisë në Shqipëri.
- Në ras se Shoqëria administrohet nga më shumë se një administrator, administratorët mund të ushtrojnë kompetencat e tyre veç e veç ose së bashkur, siç përcaktohet nga Ortakët në vendimin e emërimit të tyre.
- Administratori/et mund të transferojnë të gjitha ose një pjesë të të drejtave të tij/tyre të administrimit të një pale të tretë dhe në çdo moment ata mund të anulojnë transferimin e këtyre kompetencave.

## **NENI 9**

### **EKSPERT(ET) KONTABEL TE AUTORIZUAR**

Eksperti(et) kontabël të autorizuar do të emërohet(n) me vendim të Ortakëve në rast kur ajo kërkohet nga legjislacioni shqiptar apo kur Ortakët e konsiderojnë të nevojshme.

**NENI 10**  
**VITI USHTRIMOR**

Viti Ushtrimor fillon në 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.  
Përfundimisht, viti i parë ushtrimor fillon me datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin  
Tregtar Shqiptar dhe përfundon me datë 31 Dhjetor të atij viti.

**NENI 11**  
**SHPERNDARJA DHE PRISHJA**

Likujdimi dhe emërimi i lukujdatorit kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**NENI 12**  
**LIGJI I ZBATUESHEM**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Statut dhe me ligjin  
shqiptar.

Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë  
14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me aplikimin ose interpretimin e këtij Statuti do  
të zgjidhet pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë.

**NENI 13**  
**NDRYSHIMET**

Ky statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një statut  
të ri me vendim të ortakëve.

**ORTAKU**

**Z. AGRON GJIKONDI**



